



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:244235
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05627626

K.DH.SH.II nr.1576/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës se Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, ndaj debitorit NTP “Gentiana” me nr. Biznesi 10793288, me seli ne Prishtinë lagja Mati 1 rr. “B”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles e parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.816/22 dt.20.09.2023, me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit NTP “Gentiana” me nr. Biznesi 10793288, me seli ne Prishtinë lagja Mati 1 rr.”B”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles e parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.816/22 dt.20.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles e parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.816/22 dt.20.09.2023, ka hedhur poshtë si te palejuar prapësimin e debitorit NTP “Gentiana” me nr. Biznesi 10793288, me seli ne Prishtinë lagja Mati 1 rr.”B”, të ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.27/2015 dt.12.02.2015, te Përmbaruesit Privat Arsim Bajraktari, me seli ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë debitori përmes avokat E.Z., për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës kontestimore, neni 182.2 pika i) te LPK, dhe konstatimit te gabuar apo jo te plotë te gjendjes faktike neni 183 te LPK dhe zbatimit te gabuar te gjendjes faktike neni 184 te LPK.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Qeveria e Republikës së Kosovës -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, me datën 12.02.2015, ka paraqitur propozim për përmbarrim, ndaj debitorit NTP “Gentiana” me nr. Biznesi 10793288, me seli në Prishtinë lagja Mati 1 rr.”B”, në bazë të Vendimit nr.158/14 dt.19.12.2014, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektorit të Punës. Përmbarruesi Privat Arsim Bajraktari në Prishtinë, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.27/2015 dt.12.02.2015, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të masës ndëshkimore, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,200.00 euro, si edhe shpenzimet e procedurës

Ndaj urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 23.02.2015, me pretendimin se vendimi mbi shqiptimin e gjobës nuk është i plotfuqishëm, nuk ka klauzolën e plotfuqishmërisë dhe me këtë nuk i plotëson kushtet e dokumentit përmbarrues, propozon që gjykata ta hedh propozimin si të palejuar.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 24.02.2015, duke kundërshtuar prapësimin e debitorit dhe thekson se mbetet pranë theksimeve të paraqitura në arsyetim të vendimit të Inspektoreve të Punës, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles së Parë, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, me arsyetimin se ndaj urdhrin përmbarrimori P.nr.27/15 dt.12.02.2015, debitori ka paraqitur prapësim me datën 20.02.2015. Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, ka vendosur për prapësimin e debitorit, me aktvendimin PPP.nr.305/15 dt.20.07.2016, ku e ka refuzuar si të pabazuar. Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është refuzuar prapësimi i debitorit, debitori e ka pranuar me datën 10.11.2016 por që ndaj këtij aktvendimi nuk ka paraqitur ankesë. Andaj nga kjo kronologji Gjykata ka ardhur në përfundim se fakti se për mjetin juridik –prapësimin ka vendosur Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin PPP.nr.305/15 dt.20.07.2016, i cili aktvendim ka marrë formë të prerë dhe me të cilin është zgjidhur çështja përmbarrimore mes palëve këtu ndërgjygjese, rezulton se rrjedhimisht kjo çështje përben çështje të gjykuar, andaj tani prapësimi i ushtruar i datës 29.12.2020 i paraqitur nga debitori ndaj urdhrin përmbarrimor P.nr.27/15 duhet të hedhet i palejuar, ashtu që konform nenit 73 të LPP, nenit 391 pika d) të LPK u vendos si në dispozitiv të aktvendimit .

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-ës dhe as nenit 183 të LPK.

Edhe kjo gjykatë vlerëson dispozitën e nenit 73 paragrafi 3 të LPP i cili parasheh që: “Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit si të palejuar, sepse bazuar në kronologjinë e çështjes del se Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, ka vendosur për prapësimin e debitorit të ushtruar me dt.12.02.2015 me aktvendimin PPP.nr.305/15 dt.20.07.2016 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar të njëjtin. Debitori aktvendimin PPP.nr.305/15 dt.20.07.2016 e ka pranuar me datën 10.11.2016 por që ndaj të njëjtit nuk ka paraqitur ankesë.

Pra, bazuar në këto arsye edhe kjo gjykatë vlerëson se fakti se për mjetin juridik –prapësimin ka vendosur Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin PPP.nr.305/15 dt.20.07.2016, e i cili aktvendim ka marrë formë të prerë dhe me të cilin është zgjidhur çështja përmbarimore mes palëve këtu ndergjygyesve, rezulton se kjo çështje përben çështje të gjykuar, andaj tani prapësimi i ushtruar i datës 29.12.2020 nga debitori ndaj urdhrit përmbarimor P.nr.27/15 duhet të hedhet i palejuar konform nenit 391 pika d) të LPK.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1576/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtari
Dren Rogova